KESH Projekti i Parkut Fotovoltaik Belsh

Shteti:	SHQIPËRI
Numri i Projektit:	54350
Sektori i Biznesit	Energy Europe
Tipi i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	B
Data e synuar e miratimit:	
Statusi:	Hulumtues
Publikimi i PSD:	

Përshkrimi i Projektit

Një kredi me garanci sovrane deri në EUR 30 milionë në favor të Ndërmarrjes Shtetërore të Prodhimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare ("KESH"). Fondet e kredisë do të përdoren për ndërtimin e një impianti fotovoltaik diellor në tokë me kapacitet 50MWp në zonën e Belshit ("Projekti").

Gjithashtu, kostoja totale e projektit pritet të financohet përmes një granti për investime prej EUR 8 milionë nga Instrumenti i Investimeve të Ballkanit Perëndimor ("WBIF"), një kredi me garanci sovrane prej EUR 30 milionë nga BERZH, dhe pjesa e mbetur përmes një injeksioni të kapitalit nga KESH.

Objektivat e Projektit

Energjia e prodhuar nga impianti do të përdoret për të rritur kapacitetin e gjenerimit të KESH-it dhe për të përmbushur Detyrimin e Shërbimit Publik (rreth 30% e konsumit vjetor të energjisë elektrike importohet). Projekti i propozuar ofron një mundësi të shkëlqyer për KESH-in për të diversifikuar gjenerimin e tij aktual pothuajse tërësisht të varur nga hidrocentralet, në përputhje me i) strategjinë e tij të investimeve (kapacitetet fotovoltaike diellore +80 MWp) dhe ii) strategjinë kombëtare për zgjerimin dhe diversifikimin e miksit të prodhimit të energjisë elektrike me forma të reja të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë.

Ndikimi në Tranzicion

ETI 60

Ndikimi në tranzicion rrjedh nga zbutja e efekteve të ndryshimeve klimaterike përmes rritjes të kapaciteteve shtesë të gjenerimit të energjisë rinovuese në Shqipëri me 50 MWp. Gjenerimi i impiantit pritet të përbëjë rreth 1% të prodhimit vjetor kombëtar të energjisë elektrike.

Informacion mbi Klientin

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA

KESH është kompania kryesore e gjenerimit të energjisë elektrike në Shqipëri dhe zotëron tre hidrocentralet kryesore të vendit që përbëjnë shumicën e prodhimit vendas të energjisë elektrike. KESH zotëron dhe operon tre Hidrocentralet më të mëdha në Shqipëri me një kapacitet të instaluar të kombinuar prej 1.350 MW duke prodhuar pothuajse 65% të energjisë elektrike të gjeneruar në vend.

BERZH Përmbledhja Financiare

30,000,000.00 EUR
Deri në EUR 30 milionë kredi me garanci sovrane do të jepet për KESH.

Kosto Totale e Projektit

40,000,000.00 EUR
Kostoja totale e projektit prej EUR 40 milionë priten të financohet përmes një granti për investime prej EUR 8 milionë nga Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor ("WBIF"), një kredi me garanci sovrane prej EUR 30 milionë nga BERZH, dhe pjesa tjetër përmes një injeksioni të kapitalit nga KESH.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Projekti është kategorizuar si B sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH të vitit 2019, pasi shumica e ndikimeve janë specifike për vendin dhe mund të adresohen lehtësisht përmes masave parandaluese dhe një plani masash. Është kryer një Vlerësim Mjedisor dhe Social nga ekspert të pavarur, duke përfshirë një vizitë në vend dhe rishikimin e kapaciteteve dhe sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social të Klientit, dhe është zhvilluar dhe është miratuar një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social me Klientin.
Impianti fotovoltaik (FV) prej 50MWp dhe nënstacioni i lidhur do të ndodhen në Bashkinë e Belshit në një vend të gjelbër rreth 60 ha dhe një linjë e re rreth 9 km 110kV do ta lidhë atë me rrjetin në nënstacionin ekzistues në Kajan, i cili do të zgjerohet si pjesë e Projektit. Vendndodhja e FV është në një terren kodrinor dhe habitatet në dhe përgjatë linjës ajrore të trasmetimit (OHL) janë zakonisht të modifikuara dhe nuk kanë vlerë të rëndësishme biodiversiteti si dhe Projekti nuk ndodhet në ose pranë ndonjë zone të mbrojtur ose të njohur për biodiversitetin e saj. Zonat me vlerë më të lartë brenda zones FV dhe përgjatë rrugës se linjës së trasnmetimit (pemë, lëndina dhe pyje karstike) do të shmangen. Shpatet e thepisura midis tarracave gjithashtu konsiderohen habitate kritike pasi mbështesin jetesën e disa specieve të mollusqeve tokësore që shkaktojnë praninë e Habitatit Kritik. Përgjatë linjes ajrore të trasmetimit do të instalohen devijues zogjsh për të reduktuar rrezikun e përplasjes për zogjtë dhe do të sigurohet një gardh i përshtatur që do të vazhdojë të sigurojë qasje në vend për faunën e vogël.
Toka ku shtrihet Projekti është i përqëndruar në një zonë të kufizuar kullotash të cilësisë së ulët dhe punimet në tokat bujqësore bujqësore përreth FV dhe përgjatë linjes ajrore të trasmetimit do të shmangen. Është zhvilluar një Plan Rivendsoje që përshkruan parimet e blerjes së tokës në përputhje me PR5 dhe një Plan i Rikthimit të Jetesës do të zhvillohet dhe zbatohet gjatë procesit të blerjes kur të jetë përfunduar projekti i detajuar. Për shkak të pranisë së disa mjeteve prerëse guri të gjetura në sipërfaqe, do të kryhet një studim arkeologjik sistematik përpara ndërtimit dhe do të përgatitet një procedurë për gjetje rastësore në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe PR8. Kontraktori i cili do të kryej planin inxhinjerik si dhe ndërtimin do të jetë i detyruar të sigurojë kushtet e punës dhe të

zhvillojë plane menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe në komunitet në përputhje me legjislacionin kombëtar, kërkesat e PR2 dhe PR4. Zinxhiri furnizues i moduleve FV nuk i është nënshtruar vlerësimit ende pasi furnizuesi i mundshëm është i panjohur në këtë fazë të Projektit. Qasja e Menaxhimit të BERZH për Menaxhimin e Rrezikut të Zinxhirit të Furnizimit me Energji Diellore do të zbatohet gjatë zgjedhjes së furnizuesve të moduleve të Projektit, siç kërkohet nga Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (M&S). KESH do të kërkohet të emërojë një menaxher Mjedisor & Social për Projektin dhe të vazhdojë të zhvillojë sistemin e tyre korporativ të menaxhimit M&S dhe të përfshijë operacionin e projektit në fushën e veprimit të sistemit.
Një Përmbledhje Jo-Teknike, Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara duke përfshirë mekanizmin e ankesave të projektit janë zhvilluar dhe përveç Instrumentit të Ristrukturimit do të bëhen publike nga Klienti në faqen e tyre të internetit. Projekti do të monitorohet nga Banka, duke përfshirë rishikimin e raporteve të monitorimit dhe vizitat në vend sipas kërkesave për të siguruar përputhshmërinë me Plan Veprimin Mjedisor dhe Social dhe PR-të.

Bashkëpunimi Teknik

Projekti përfitoi nga dy Bashkëpunime Teknike të financuara nga grante të mobilizuara nga BERZH duke përdorur Fondet e Qeverisë Austriake (HIPCA Austria) për përgatitjen e projektit. Më specifikisht përfshijnë: i) Due Diligence Mjedisore dhe Sociale; dhe ii) Studimin e Fizibilitetit, Projektimin Bazë dhe Mbështetjen gjatë procesit të Prokurimit. Kostoja e përgjithshme e Bashkëpunimeve Teknike në total është rreth EUR 280 mijë.
Gjithashtu, projektit iu akordua një Bashkëpunime Teknik prej EUR 1.2 milionë nga WBIF për të siguruar mbështetje për Njësinë e Zbatimit të Projektit dhe Mbikëqyrjen Teknike.

Vlera e Shtuar

Banka shton vlerë duke: i) ofruar parandalimin e rrezikut në lidhje me strukturën e financimit të kërkuar për zbatimin e Projektit duke përfshirë mobilizimin e financimit me grante nga WBIF dhe gjithashtu; ii) ndihmuar klientin të arrijë standarde më të mira në aspektin e Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

Informacion Kontakti i Kompanisë

Arta Gurabardhi
Arta.Gurabardhi@kesh.al
www.kesh.al
Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Albania

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:
Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.
OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.
Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .
MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjsinë ndaj Projektit për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të dërguar një kërkesë për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.